

**V E N D I M Nr.08**

**I**

**ASAMBLESE SË PËRGJITHSHME TË ORTAKUT TE VETEM  
TË SHOQËRISË "SAFE SECURITY ALBANIA" SH P K**

Sot në Tiranë, më datë 23(njezetetre) Shkurt 2023(dy mijë e njëzete e tre),ne selinë e shoqërisë, zhvillohet mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve të Shoqërisë "SAFE SECURITY ALBANIA" Sh.p.k..

Shoqëria "SAFE SECURITY ALBANIA" Sh.p.k., person juridik shqiptar, i regjistruar më datën 20.12.1995, në Qendrën Kombëtare të Bisnesit (QKB) filiali Tiranë dhe e pajisur nga kjo zyrë me Çertifikatë Regjistrimi, Person i Tatuashëm, me numër identifikimi (NUIS) J72207013A me seli në adresën: TIRANE Rruga Bajram Curri, Zona Kadastrale Nr. 8160, Pasuria me Numer 2/276-D10, Vol. 39, Faqe 107, Godina ETC, Shqipëri.

Shoqëria "SAFE SECURITY ALBANIA" Sh.p.k., ka një kapital të saj në shumën prej 190,593,000 (njqind e nentedhete milion e peseqind e nentedhete e tre mijë) Lekë, të ndarë në një numër të përgjithshëm kuotash 190,593 kuota dhe zotërohet nga ortaku i shoqërisë shoqëria **CONCORD INVESTMENT**, e cila është zotëruer e 190,593 kuotave, me vlerë të përgjithshme prej 190,593,000 (njqind e nentedhete milion e peseqind e nentedhete e tre mijë) Lekë, që përbën 100% (njqind përqind) të kapitalit themeltar të shoqërisë "SAFE SECURITY ALBANIA" Sh.p.k..

Shoqëria "SAFE SECURITY ALBANIA" Sh.p.k., gjatë veprimtarisë së saj drejtohet nga Administratori: **Z.Ervin Vaso**.

Kjo mbledhje e Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve të Shoqërisë "SAFE SECURITY ALBANIA" Sh.p.k., është thirrur me kërkesën e ortakut te shoqërisë.

Verifikohet pjesëmarrja e ortakëve të shoqërisë dhe rezulton që marrin pjesë dhe janë të pranishëm ortakët e shoqërisë, si më poshtë :

Shoqëria "Concord Investment"Sh.p.k., përfaqësuar nga ortakët e shoqërisë **Z.Adrian Dulaku, Z.Artan Dulaku dhe Z.Genci Dulaku, të cilët përfaqësojnë 100% (njqind per përqind) të kapitalit të shoqërisë "SAFE SECURITY ALBANIA" Sh.p.k.**, gjë që do të thotë se Asamblea e Përgjithshme e Ortakëve Shoqërisë "SAFE SECURITY ALBANIA" Sh.p.k., është mbledhur rregullisht dhe në përputhje të plotë me Ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" me ndryshimet e tij dhe Statutit të shoqërisë, e deklaroi të mbledhur rregullisht dhe në gjendje për të diskutuar dhe vendosur mbi;

**Rendin e ditës si më poshtë:**

1. Bashkimi me përthithje të shoqërisë Përthithëse "SAFE SECURITY ALBANIA" Sh.p.k dhe shoqërisë së Përthithur "GLOB 06" Sh.p.k. Shoqëria SAFE SECURITY ALBANIA" Sh.p.k do te jete shoqëria perthithese dhe do te perthithe shoqërine "GLOB 06" Sh.p.k., qe eshte shoqëria e perthithur.
2. Treguesit e Pasqyrave Financiare të shoqërive "SAFE SECURITY ALBANIA" Shpk dhe "GLOB 06" Shpk dhe Inventarët Kontabël të analizuara në Raportin e Ekspertimit datë 12/10/2022 të Ekspertit Kontabël të Regjistruar FILTO AUDITING shpk, do të jenë baza mbi të cilën do të përllogariten aktivitet dhe pasivet e Shoqërive "SAFE SECURITY ALBANIA" Shpk dhe "GLOB 06" Shpk. Aktiviteti i vitit 2022 do të konsiderohet i përbashkët duke filluar nga data 01.01.2022.
3. Miratimin e marreveshjes se bashkimit.
4. Emërtimi i Shoqërisë pas bashkimit do të jetë "SAFE SECURITY ALBANIA" Shpk.
5. Selia e shoqërisë do të jetë ajo e shoqërisë "SAFE SECURITY ALBANIA" Shpk në adresën: TIRANE Rruga Bajram Curri, Zona Kadastrale Nr. 8160, Pasuria me Numer 2/276-D10, Vol. 39, Faqe 107, Godina ETC, Shqipëri.

6. Statuti dhe Akt themelimi do të mbeten ato të shoqërisë "SAFE SECURITY ALBANIA" Shpk para bashkimit me përthithje.
7. Kapitali themeltar i Shoqërisë "SAFE SECURITY ALBANIA" Shpk pas bashkimit me përthithje do të mbetet 190,593,000 Lekë si me poshtë: CONCORD INVESTMENT perqindja 100%, Vlera 190,593,000 Leke
8. Administrator i Shoqërisë "SAFE SECURITY ALBANIA" Shpk pas bashkimit me përthithje, do të jetë Z. Ervin Vaso.
9. Ngarkohet Z. Ervin Vaso, të depozitojë pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit, këtë Vendim dhe cdo dokument tjetër të lidhur me procesin e regjistrimit të këtij vendimi pranë QKB-së.

Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve të Shoqërisë "SAFE SECURITY ALBANIA" Sh.p.k., pas diskutimit të ortakut të vetëm të shoqërisë CONCORD INVESTMENT dhe një shqyrtimi të dokumentacionit dhe akteve përkatëse në lidhje me rendin e ditës, në zbatim të nenit 18, paragrafi 1, pika "b" dhe "i" të nenit 81 dhe nenit 87, paragrafi 1, e vijues të Ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008, "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" në përfundim të diskutimeve, në unanimitet të plotë, në përfundim,

#### V E N D O S I :

1. Të miratojë bashkimin me përthithje të shoqërisë Përthithëse "SAFE SECURITY ALBANIA" Sh.p.k dhe shoqërisë së Përthithur "GLOB 06" Sh.p.k. Shoqëria "SAFE SECURITY ALBANIA" Sh.p.k do të jete shoqëria perthithese dhe do të perthithe shoqerine "GLOB 06" Sh.p.k., qe eshte shoqeria e perthithur.
2. Treguesit e Pasqyrave Financiare të shoqërive "SAFE SECURITY ALBANIA" Shpk dhe "GLOB 06" Shpk dhe Inventarët Kontabël të analizuar në Raportin e Ekspertimit datë 12/10/2022 të shoqërisë FILTO AUDITING shpk, do të jenë baza mbi të cilën do të përlllogariten aktivet dhe pasivet e Shoqërive "SAFE SECURITY ALBANIA" Shpk dhe "GLOB 06" Shpk. Aktiviteti i vitit 2022 do të konsiderohet i përbashkët duke filluar nga data 01.09.2022.
3. Miratimin e marreveshjes se bashkimit.
4. Emërtimi i Shoqërisë pas bashkimit do të jetë "SAFE SECURITY ALBANIA" Shpk.
5. Selia e shoqërisë do të jetë ajo e shoqërisë "SAFE SECURITY ALBANIA" Shpk në adresën: TIRANE Rruga Bajram Curri, Zona Kadastrale Nr. 8160, Pasuria me Numer 2/276-D10, Vol. 39, Faqe 107, Godina ETC.
6. Statuti dhe Akt themelimi do të mbeten ato të shoqërisë "SAFE SECURITY ALBANIA" Shpk para bashkimit me përthithje.
7. Kapitali themeltar i Shoqërisë "SAFE SECURITY ALBANIA" Shpk pas bashkimit me përthithje do të mbetet 190,593,000 Lekë si me poshtë: CONCORD INVESTMENT perqindja 100%, Vlera 190,593,000 Leke
8. Administrator i Shoqërisë "SAFE SECURITY ALBANIA" Shpk pas bashkimit me përthithje, do të jetë Z. Ervin Vaso.
9. Ngarkohet Z. Ervin Vaso, të depozitojë pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit, këtë Vendim dhe cdo dokument tjetër të lidhur me procesin e regjistrimit të këtij vendimi pranë QKB-së. Ky vendim nënshkruhet dhe hyn në fuqi sot me datë 23.02.2023

#### ASAMBLEJA E ORTAKEVE TE SHOQERISE PERTHITHESE "SAFE SECURITY ALBANIA" SH.P.K.

#### ORTAKU I VETEM

Shoqëria "CONCORD INVESTMENT" Sh.p.k.

Përfaqësuar nga:

ARTAN DULAKU

ADRIAN DULAKU

GENCI DULAKU

